



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 166

Datë: 9/2/2022

**KONKURS**

***Për punë praktike në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"***

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", shpall konkurs për pranimin e studentëve të UP-së në punë praktike në kuadër të Administratës Qendrore të UP-së dhe zyrave administrative në njësi akademike (fakultete).

**Informatat e përgjithshme:**

1. Qëllimi i konkursit është angazhimi i studentëve në punë profesionale në një orar fleksibil, të përcaktuar në koordinim me mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë nga ana e UP-së. Kjo iniciativë ka për synim avancimin e studentëve dhe dhënien e ndihmesës për t'u kyçur në tregun e punës, duke mbështetur aftësimin profesional të tyre, por njëherësh, në bashkëpunim me studentët, do të punohet në avancimin e objektivave strategjike të UP-së.
2. Studentët e profileve të ndryshme, të cilët do të bëhen pjesë e punës praktike në UP, do të përfitojnë nga kjo mundësi, e cila, pos tjerash, iu ofron atyre mentorim, përvojë pune, si dhe kompensim mujor prej **80 euro**.
3. Programi i praktikës do të zgjasë nëntë (9) **muaj** brenda vitit kalendarik 2022.
4. Në kuadër të punës praktike për vitin 2022 do të angazhohen dy grupe të studentëve praktikantë nga të gjitha programet studimore të UP-së, në kohëzgjatje prej pesë (5), respektivisht katër (4) muajve.  
Grupet do të angazhohen si në vijim:

**4.1. Grupi I**

- a) Numri i studentëve: **80**.
- b) Periudha e angazhimit në punë praktike: **1 mars 2022 deri më 29 korrik 2022**.
- c) Lartësia e pagesës mujore: **80 €**.

**4.2. Grupi II**

- a) Numri i studentëve: **80**.
- b) Periudha e angazhimit në punë praktike: **1 shtator 2022 deri më 30 dhjetor 2022**.

c) Lartësia e pagesës mujore: 80 €.

- Numri i studentëve që do të përzgjidhen nga fushat specifike të studimit do të caktohet sipas nevojave të brendshme të njësive akademike dhe Universitetit.
- Detyrat dhe përgjegjësitë e praktikantit do të caktohen nga mbikëqyrësi (në varësi se ku caktohet praktikanti).
- Praktikantët, në përfundim të programit të punës praktike, do të pajisen me certifikatë nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.

#### **Kriteret për aplikim:**

- Kandidati për punë praktike duhet të jetë student i rregullt në njërin prej njësive akademike të UP-së dhe të ketë notë mesatare jo më të ulët se 8.00.
- Studentët të cilët përzgjidhen për të kryer punë praktike duhet të jenë studentë të vitit të tretë ose të katërt të studimeve në nivelin baçelor, ose të jenë të studentë të niveleve tjera të studimeve.
- Studentët të cilët këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar në konkurset paraprake, të organizuara përmes UP-së, nuk do të merren në konsideratë për punë praktike, përveçse nëse numri i të interesuarve për punë praktike është më i vogël se numri i studentëve të paraparë me këtë konkurs.
- Përparësi do të kenë studentët që nuk kanë përfitur nga programet e mëparshme të praktikës nga institucione ose organizata të tjera.
- Praktikanti/ja preferohet të ketë: Shkathtësi të komunikimit, aftësi të mira analitike, shkathtësi dhe njohuri në aplikimin e programeve kompjuterike nga pako Microsoft Office, programim (për IT) dhe shkathtësi në punë teknike, njohuri të avancuara të gjuhës angleze, në të shkruar dhe të folur (për praktikantët në Zyrën për marrëdhënie me jashtë dhe në Rektoratin e UP-së), dizajn grafik, fotografi, aftësi të punës në grup, motiv për t'u vetëzhvilluar.

#### **Mënyra e aplikimit:**

Studentët kanë mundësi të aplikojnë duke ndjekur hapat si në vijim:

- Vizitoni uebfaqen: [ekarriera.uni-pr.edu](http://ekarriera.uni-pr.edu), duke u kyçur me nr. e SEMS ID-së dhe fjalëkalimin e njëjtë që përdorni në SEMS. Plotësoni CV-në tuaj dhe letrën motivuese në sistem, i shkarkoni në PDF dhe i dërgoni në emailin [qzhk@uni-pr.edu](mailto:qzhk@uni-pr.edu) me subjektin: Aplikimi për punë praktike në UP.

Dokumentacionit për aplikim duhet t'i bashkëngjitet edhe pasqyra e notave, e lëshuar nga njësia akademike përkatëse, e skanuar dhe në formatin PDF.

Për çdo pyetje të mundshme studentët mund të na shkruajnë në emailin: [qzhk@uni-pr.edu](mailto:qzhk@uni-pr.edu).

Afati për aplikim nis nga data **9.2.2022** dhe do të jetë i hapur deri më **18.2.2022**.

